

JANI THOMAJ

GRUPE FJALËSH TË BASHKËLIDHURA ME FRAZELOGJIZMA

Është i njohur tashmë mendimi se gjenetika kompozitat në gjuhët indoevropiane e kanë burimin nga togfjalëshat¹, pasi kanë pësuar një varg ndryshimesh të shumëllojta të karakterit fonetik, morfologjik e semantik. Mirëpo, këto ndryshime të shumta e të shumëllojta nxjerrin një varg problemesh të rëndësishme, që duhen studjuar secili më vete dhe njëkohësisht i pashkëputur nga të tjerat. Kjo do të hidhte dritë edhe mbi thelbin e marrëdhënieve ndërmjet togfjalëshit e kompozitës «që ka lidhje gjenetike me të», si duhet kuptuar kjo lidhje gjenetike, në ç'drejtime e në ç'shkallë qëndron bashkëlidhja e kompozitës me togfjalëshin përgjigjes.

Fjalët e përbëra e të përngjitura tani kanë zënë vend si objekt i rëndësishëm i studimeve gjuhësore shqiptare, sidomos në disa punime të veçanta të A. Kostallarit, në të cilat është bërë si analiza e klasifikimi i materialit konkret, ashtu edhe trajtimi teorik e përgjithësues i kompozitave të shqipes. Me tipe e probleme më të veçanta janë marrë edhe A. Xhuvani, K. Cipoja, E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj e të tjerë. Edhe në disa gramatika kanë gjetur vend kompozita a grupe kompozitash gjatë trajtimit të secilës pjesë kryesore të ligjëratës. Megjithë këto, nuk mund të thuhet se studimi i kompozitave të shqipes është i plotë e i gjithanshëm, sepse ka ende probleme, tipe e anë të veçanta të pastudjuara ose të pathelluara mjaftueshëm. Një tip të tillë p.sh. e përbëjnë disa kompozita të shqipes që bashkëlidhen me togfjalësha frazeologjike si nga përbërja e gjymtyrëve, ashtu edhe nga përmbajtja, nga kuptimi kategorial ose ai i veçantë leksikor. Karakteri dhe shkallët e kësaj bashkëlidhjeje (frazeologjizëm-kompozitë) nuk kanë qenë deri sot objekt i një vështrimi të veçantë sistematik e të gjithanshëm, megjithëse vlerësime e mendime të copëzuara janë dhënë, siç do të shënohen më tutje.

Nga pikëpamja semantiko-emocionale gjithë kompozitat e shqipes mund t'i ndajmë në dy grupe të mëdha: a) kompozita asnjane (dhe zakonisht me funksion emërtues të drejtpërdrejtë), si *orëndreqës*, *vargmal*, *bregdet*, *shitblerje*, *kryeqytet*, *ballëgjerrë* etj. dhe b) kompozita figurative-emocionale (që kanë edhe kuptim metaforik), si *krahëhapur*, *kokëfortë*,

1) Shih *Grundriss der vergleichenden Grammatik der indogermanischen Sprachen*, von Karl Brugmann und Berthold Delbrück, Strassburg, 1906: «Fjalët e përbëra ose kompozitat janë togfjalësha të perceptuar si një njësi», f. 35; më poshtë: «...që nga koha indogjermane e vjetër, prej çdo togfjalëshi, që paraqiste një lidhje të ngushtë sintaktike, në disa rethana të caktuara mund të formohej një kompozitë, pa qenë i domosdoshëm pozicioni i kontaktit për njësimin në një fjalë të vetme...», f. 49-50,

dorëlëshuar barkgjerë, zemërthyer etj. Shumica e kompozitave që trahen në këtë punim, bëjnë pjesë në grupin e dytë, sepse bashkëlidhen me frazeologjizma, që përgjithësisht kanë kuptim metaforik dhe ngjyrim emocional. Ndër punime, gramatika e fjalorë të ndryshëm kompozitat këtij tipi nuk janë veçuar nga fjalët e tjera të përbëra e të përngjitura të shqipes. Veç kësaj, vështrimi i tyre ka qenë krejt i planit gramatikor e deri diku leksikografik, kurse analiza leksiko-semantike (kemi parasysh jo vetëm gjendjen, por edhe zhvillimin që nga formimi e deri tani, sidomos veçoritë dalluese ndërmjet kompozitës dhe togfjalëshit frazeologjik përgjegjës), kjo analizë, pra, ka qenë e pjesshme ose ka munguar².

Bashkëlidhja e kompozitës me frazeologjizmin duhet parë si një dukuri e zakonshme dhe e ligjshme, por shqyrtimi i kësaj dukurie në gjuhën shqipe nuk mund të bëhet pa një koncept të qartë mbi fjalën e përbërë e të përngjitur. Një pjesë e mirë e këtyre fjalëve janë eufemizma, distrazizma ose kompozita dëshirore a urdhërore. Kjo natyrë semantike-emocionale vërehet edhe tek togfjalëshat frazeologjikë përgjegjës, të cilët përdoren në plan të figurshëm dhe kanë ngjyrim të theksuar emocional. Prej kësaj del që në studimin e kompozitave të këtij tipi duhet parë njëkohësisht në dy drejtime: nga kategoria e kompozitave të shqipes, të cilat kanë tipare dalluese prej fjalëve me strukturë tjetër dhe nga togfjalëshat frazeologjikë, me të cilët bashkëlidhen kompozitat në fjalë.

*

* *

Nga kompozitat popullore që përmend A. Xhuvani në studimin «Kompozitat»³, pjesa kryesore ka temë kuptimore të figurshme, si *djegës gur, ngrënëzi, djerraditë, thirravajë, trutharë, rrënjëdalë, dorështrënguar, buzëplasur, vëllavrasës, gjakderdhës, gjakpirës etj.* A. Xhuvani, duke shtjelluar kuptimin e disa kompozitave ka pranuar që ato bashkëlidhen me frazeologjizma, sepse i vë ballaballas dhe kështu një bashkëlidhje e tillë duket, p.sh. *puthador-i* «ai që i puth dorën [tjetrit, quheshin puthador në kohën e mesme ata që përuleshin, u krihnin bishtin, u binin në kambë feudalëve]; *rrahadere-je* «ai që rreh, që trokit *dyert* për të lypë, lypë, lypsar»; *zanafillë-a* «të zanët fill të një gjaje a të një pune»; *dorëzanë* «atij të cilit i asht zanë dora për një punë a për një zotim të dhanë...»; *bukëshkalë-i* «ai që shkel bukën e dhanë prej tjetrit...»; *bukëdhënë* «ai që jep bukë, ai që asht dorëhapët e zemërbardhë»; *nderbamë-i* «ai që i ban nder tjetrit, që i gjindet»; *pishëvënë-a* «ajo që i shtie (i vë) pishë zjarrin tjetrit, që shtie, ngatërron, ngatërrestare»; *pikërenë-i* «atij që i kërrenë pika»; *shkumbëngarë - i* «atë që e nget shkumba... epileptik»; *padalë* «vajzë së cilës edhe nuk i ka dalë fati»; *buzëpaqeshur* «atij që nuk i ka qeshur buza, i vrëret, i zymtë...» etj.

Edhe K. Cipoja⁴ është afër këtij kuptimi të bashkëlidhjes së disa kompozitave me frazeologjizma, megjithëse kufirin ndërmjet këtyre dy kategorive (frazeologjizëm-fjalë) nuk e sheh gjithnjë qartë. Po të kemi p

2) Është fjala gjithnjë për kompozitat që bashkëlidhen me togfjalëshat frazeologjikë dhe jo për kompozitat në përgjithësi ose për tipe të tjera, që kanë gjetur pasqyrim në studime të veçanta

3) A. Xhuvani, *Studime gjuhësore*, 1956, 187-191.

4) K. Cipo, *Rreth disa kompozitave*, BISH, 1948, I, 51-54.

rasysh se për K. Cipon viza lidhëse është shenjë kompozimi, atëhere kup-tohet pse ai përfshin në «kompozita plaka të shqipes» njësi të tilla si *thashë-e-theme*, si dhe disa të tjera që i shënon në punimin «Kompozitat determinative»⁵, si *pishë-vënë*, *bukë-shkalë-*, *pikë-rënë*; *zemër-madh*; *gjuhë-lopatë*, *gojë-mjaltë*, *dorë-gjatë*, *gojë-ëmbël*; *zemër-çelë* etj.

E. Çabej në «Disa eufemizma të shqipes»⁶ e shpjegon pasurinë e gjuhëve të Ballkanit në eufemizma «me sintaksën e me frazeologjinë më vete që kanë» ato. «Duke qënë pra se edhe eufemizmat janë një pjesë e së folurit figurativ, — shkruan ai, — nga kjo shpjegohet pasuria e gjuhës sonë në këto». Kështu shpjegohet *gojëlidhuri* si një kompozitë desiderative, si të thomi «ai që ju *lidhët goja*»; emri i *shtozovalleve* nxirret nga urimi *shtoi Zot vallet*, pra një fjalë e dalë nga një fjali e tërë; *qoftëlargu* shpjegohet me mallëkimin «ai që *qoftë larg*» etj. Për t'u përmendur është se këtu autori për të dyja kategoritë (kompozitë-togfjalësh) vë bazë të përbashkët — psikologjinë popullore, paragjykimet, demonologjinë etj. Karakteri eufemik i shprehjes është parë si në fjalë, ashtu edhe në togje fjalësh e frazeologji. Këtyre u duhet shtuar që dukuri të tilla nuk mund të shpjegohen vetëm me bazën psikologjike, demonologjike etj., as edhe me karakterin e përgjithshëm eufemik. Këto dukuri janë vetëm një shfaqje, një lloj a një tip i bashkëlidhjeve të përgjithshme të kompozitave me togfjalëshat dhe dukuri të tilla vërehen po ashtu në gjuhë të tjera indoevropiane jo-ballkanike.

Më gjerë janë trajtuar kompozitat dëshirore dhe urdhërore nga A. Kostallari⁷, i cili qoftë në trajtimin teorik, qoftë në shpjegimet e veçanta, vendos një lidhje ndërmjet këtyre kompozitave dhe togfjalëshave bazë, si p.sh. *barktharë* «t'u *thaftë ose iu thaftë barku*», *buzëlidhur* «t'u *lidhtë buza*. . .», *buzëplasur* «të *plastë buza*. . .», *derëmbyllur* «. . . që iu *mbylltë dera*. . .»; *ditëprerë* «iu *prefshin ditët*. . .», *dorëtharë* «t'u *thaftë dora*. . .», *farëhumbur* «të *humbtë fara*», *gjakshuar* «. . . që iu *shoftë gjaku*. . .», *pikë-rënë* «të *rëntë pika*. . .», *vulëhumbur* «të *humbtë vula*. . .» etj. Po të vështrohen këto kompozita nga aspekti i prejardhjes, mund të nxjerrim më një anë grupin e frazeologjizmave pashtrirmorë ose në trajtë mallëkimi, si *t'u thaftë barku*, *t'u lidhtë buza*, *t'u thaftë dora*, *të humbtë vula* etj. dhe kompozitat që bashkëlidhen me ta, si *barktharë* *buzëlidhur*, *dorëtharë*, *vulëhumbur* etj. A. Kostallari ka zbuluar kështu, nga pikëpamja e këtij punimit tonë, një tip të veçantë fjalësh të bashkëlidhura me frazeologjizma dhe pasi ai e ka studjuar në mënyrë të gjithanshme këtë tip së bashku me disa tipe të tjera me rëndësi, nuk po i rimarrim më. Po lidhur me detyrën e këtij punimi, duhen theksuar tri arritje të rëndësishme: Së pari, autori e ka parë gjithë tipin e kompozitave të studjuara, në bashkëlidhje me togfjalëshat në mënyrë sistemore e të organizuar, duke kristalizuar kështu vetë tipin; Së dyti, ka trajtuar në mënyrë të plotë vlerën bisemantike të disa kompozitave, që bashkëlidhen me togfjalëshat frazeologjikë; Së treti, ka ndarë mënjanë kompozitat e formuara sipas modeleve të bahuve prej formimeve sipas pranëvënies.

5) BISH, 1948, II-III, 9-12.

6) BSH, 1949, I, 72-84.

7) A. Kostallari, *Kompozitat dëshirore dhe urdhërore të shqipes*, SF, 1968, IV, 23-70.

Së fundi edhe Dh. Demiraj pranon një lidhje të drejtpërdrejtë burimi ndërmjet disa kompozitave dhe togfjalëshave: «Kemi edhe disa folje kompozita prej burimi popullor si *vërej*, *bëzaj*, *shtëzoj*, që kanë dalë përkatësisht nga përngjithja e togfjalëshave *vë re*, *baj za*, *shtoje*, *Zot*»⁸.

Siç shihet, ka arsye të mjaftueshme për ta ndarë dhe për ta studjuar veçan grupin e kompozitave që bashkëlidhen me frazeologjizma. Njësi të tilla formojnë një grup të madh me tipare të përbashkëta, siç është zhvillimi i njëjtë, karakteri i figurshëm i kuptimit, ngjyrimi i theksuar emocional etj. Kryesisht këtu hyjnë, siç u tha, disa kompozita eufemike, dëshirore e urdhërore, por edhe disa përngjitje asnjënjëse të tipit *vërej*, *anëmbanë* etj. Ndryshimet gjatë procesit të formimit të këtyre kompozitave, shkallët e bashkëlidhjeve me frazeologjizmat, tipet e kategorisë që formohen e sidomos proceset e brendshme semantike që ndodhin etj. janë çështje që meritojnë studim më të thelluar. Aspekti socialinguistik i tyre (etnolinguistik e psikolinguistik) përbën, gjithashtu një fushë të pasqelur. Po këto probleme të gjera e të shumëllojta nuk mund të zgjidhen me një punim të vetëm. Ajo që del njëherë në plan të parë është përcaktimi i tipeve kryesore të fjalëve të përbëra e të përngjitura, që bashkëlidhen me frazeologjizma, si dhe studimi i ndërtimit, i përmbajtjes dhe i shkallëve të bashkëlidhjes së këtyre fjalëve me frazeologjizmat përkatës.

Në krye del pyetja: ç'kuptohet me «bashkëlidhje» të fjalëve me togfjalësha frazeologjike? Siç u tha që në fillim të punimit, në gjuhët indoevropiane kompozitat gjenetike e kanë burimin tek togfjalëshat. Kjo lidhje gjenetike shfaqet si bashkëlidhje, sepse kompozita që ka togfjalëshin si burim ose si bazë, trashëgon prej tij mjaft elemente, si p.sh. gjymtyrët, llojin e raporteve sintaksore, kuptimin kategorial dhe atë të veçantë leksikor, duke përfshirë edhe ngjyrimin emocional. Por këtu nuk duhen harruar dy sende: së pari, elementet e trashëguara tek kompozita nuk janë plotësisht ose gjithnjë të njëjta me ato të togfjalëshit përgjegjës. Kështu, p.sh. raportet sintaksore tek kompozita pothuajse shuhen fare, njësimi kuptimor forcohet e bashkë me këtë vijnë edhe disa ndryshime në kuptimin kategorial dhe në atë të veçantë leksikor. Së dyti, shkallët e bashkëlidhjes janë të ndryshme, ato nisin që me përngjitjen e gjymtyrëve të togfjalëshit (si tek delokutivët *vërej*, *bëzaj*, *anëmbanë*, *thashetheme* etj.) dhe mbarojnë me lidhje më të largëta, në të cilat togfjalëshi ka shërbyer si bazë a si model për formimin e kompozitës, po jo si burim i drejtpërdrejtë. Prandaj, mendojmë se lidhja gjenetike e kompozitës me togfjalëshin nuk duhet marrë gjithnjë në mënyrë të drejtpërdrejtë dhe mekanike, ajo duhet kuptuar më gjerë, me një vështrim që të përfshijë edhe lidhjet e një kompozite me një frazeologjizëm nga i cili buron drejtpërdrejt, edhe ato lidhje më të largëta të një kompozite me një frazeologjizëm, i cili nuk ka shërbyer si burim i drejtpërdrejtë për të. Formimi i fjalëve me përngjitjen e gjymtyrëve të frazeologjizmit është shkalla e parë, më e forta e kësaj bashkëlidhjeje, formimi i fjalëve mbi bazën e togfjalëshave frazeologjike, nëpërmjet përbërjes, përngjitjes e me

8) Sh. Demiraj, *Morfologjia e gjuhës shqipe*, 1969, II, 255; Termi *kompozitë* është përdorur këtu me kuptimin e fjalëve të përbëra e të përngjitura. *Vërej* e ka trajtuar më parë G. Meyer, në «*Etymologisches Wörterbuch der albanesischen Sprache*», 1891, f. 362, si dhe E. Çabej, BUSHT, Seria e Shkencave shoqërore, 1960, IV, f. 82; për *bzaj* shih gjithashtu më parë E. Çabej, BUSHT, Seria Shkencat shoqërore, 1960, IV, f. 82.

ndihmën e prapashtesimit, është një tjetër shkallë e bashkëlidhjes fjalë-frazeologjizëm.

Dihet se formimi i fjalëve të përbëra e të përngjitura përputhet me natyrën e shqipes si një gjuhë flektive me prirje të forta sintetizimi në fushën e formimit të fjalëve. Fjala në gjuhën shqipe, si njësi leksikore me strukturë të mbyllur, është rezultat i një leksikalizimi e gramatikalizimi njëkohësisht, aq më tepër kur ajo formohet nga një frazeologjizëm ose mbi bazën e një togfjalëshi me strukturë të hapur, qoftë edhe frazeologjik. Në këto procese njësia e formës i përngjitet menjëherë dhe drejtpërdrejt njësisë së kuptimit, i cili në fjalën e përbërë a të përngjitur nuk mund të ndahet më dysh sipas gjymtyrëve.

Prirja për sintetizim të mjeteve të shprehjes leksikore është më e theksuar për gjuhën e folur, e cila, më shumë se e shkruara, parapëlqen mjete gjuhësore më të shkurtëra. (Kjo del, p.sh., po të ndiqet se si përdoren në këto variante të gjuhës letrare njësitë e strukturave të ndryshme, si: *djali me sy të zes — djali syzi — syziu*, duke mbajtur parasysh, pa dyshim, edhe aspektin stilistik). Këtë e tregojnë edhe formimet e tipit *vërej, thashethemet, krahëhapur* etj. Më i vjetër, me sa duket, është tipi popullor me zanore lidhëse *a, si djegagur, puthador* etj.

Tipe të veçanta bashkëlidhesh të fjalëve me frazeologjizma në gjuhën shqipe krijohen jo vetëm sipas llojit të formimit (përbërje a përngjitje), por edhe sipas rendit të gjymtyrëve e strukturës së frazeologjizmave përgjegjës, sipas vlerës leksiko-gramatikore të fjalës që formohet etj. Në klasifikimin e këtyre tipeve një kriter i vetëm është i pamjaftueshëm.

Sipas shkallëve të bashkëlidhjes së fjalëve me togfjalëshat, në këtë punim janë marrë katër grupe kompozitash: kompozita që janë formuar drejtpërdrejt nga frazeologjizma, kryesisht me përngjitje të gjymtyrëve të tyre; kompozita që bashkëlidhen me frazeologjizma, të cilët nisin me parafjalën *me*; kompozita që bashkëlidhen me frazeologjizma, të cilët dalin në ligjërime në trajtë fjalie; kompozita që bashkëlidhen me frazeologjizma, por që kanë rend të përkundërt të gjymtyrëve.

*
* *

I. Grupin e parë e përbëjnë fjalët që janë formuar kryesisht me përngjitje të gjymtyrëve të togfjalëshave frazeologjike (rrallë edhe me prapashtesim), si *vë re — vërej, baj za — bëzaj, shtoji Zot — shtëzoi, zë vend — zëvendës, ngas rend — ngarend, fal nder — falnderoj, marr vesh — marrëveshje, vë mendjen — vëmendje* e ndonjë tjetër. Është një grup i vogël kryesisht foljesh e emrash pa ndryshime kuptimore nga frazeologjizmat burimore. *Formësimi gramatikor* i tyre si fjalë është i plotë dhe nuk paraqesin problem drejtshkrimor, por paralelisht me to, pothuajse me të njëjtën denduri, përdoren në gjuhën e sotme shqipe edhe togfjalëshat frazeologjike përgjegjës. Më tej këta delokutivë janë zhvilluar si tema fjalëformuese, si *vërejtje, shtëzim* etj., gjë që tregon nënshtrimin e tyre të plotë ndaj sistemit gjuhësor.

Siç shihet, në disa raste me prapashtesim ndryshon edhe kategoria leksiko-gramatikore e fjalës së formuar: në bashkëlidhje me tipin *foljor* të frazeologjizmave formohen *emra*, si: *zë vend — zëvendës, vë mend — vëmendje, marr vesh — marrëveshje* etj.

Një grup më të madh këtu e përbëjnë fjalët me përngjitje të përdrejtë të atyre togfjalëshave frazeologjike, që ndërtohen me gjymime të bashkërenditura. Emrat e formuar me këtë mënyrë u nënshtrojnë paradigmatave të gjalla dhe si rrjedhim njëfjalësimi është kryer plotësisht e shprehet me mjete morfologjike përkatëse, si; *farë e fis* — *farëthash e them* — *thashethemE, ec e jakë* — *ecejakE, çap e jakë* — *çape* etj. Ky grup fjalësh po i humbet në shqipen e sotme lidhjet me togfjalëshat burimorë, të cilët shkallë-shkallë kanë dalë ose po dalin nga përdorimi. Është interesant të vërehet se ky proces pothuajse është krijuar tek bashkëlidhjet gramatikiht homogjene (si *farë e fis* — *farefis*), kurse tek bashkëlidhjet gramatikiht johomogjene ruhen ende në ligjërimin e frazeologjizmat burimorë p.sh. «Zbritën në oborr dhe bënin çap e aty përpara» (H. Petrela, *Kronikë e viteve të paharruara*, 1965); «Lidhja shkojë kush të dojë për rrotat në Tiranë. U mërzi ta ecë e jakë!» (D. Agushi, *Rrota që s'levizin*, 1967) etj.

Ndajfoljet e formuara me këtë mënyrë vijnë zakonisht prej frazeologjizmesh që ndërtohen me marrëdhënie këpujore, ku lidhëza e bashkërenditëson procesin e njëfjalësimit, si *anë e mbanë* — *anëmbanë, rreth e rrethull* — *rretherrotull, anë e kënd* — *anekënd, shkel e shko* — *shkelesh e li* — *lesheli* etj. Ky grup fjalësh i ka ende të gjalla lidhjet me togfjalëshat burimorë, të cilët përdoren paralelisht si të tillë në gjuhën e sotme shqipe. Për shkak të mungesës së treguesve gramatikorë të njëfjalësimit, kufiri ndërmjet togut të fjalëve dhe fjalës së formuar me këtë mënyrë në këtë rast, është i paqartë dhe kjo ka ngjallur diskutime në shtet dimet shqiptare⁹. Megjithatë, prirja e përgjithshme e gjuhës së sotme shqipe për njëfjalësimin e disa togfjalëshave e të lokucioneve është e paqartë: kjo prirje po përfshin tani edhe togje frazeologjike që ndërtohen me marrëdhënie nënrenditjeje e me parafjalë, si: *ballë për ballë* — *llëpërballë, krah për krah* — *krahpër krah, dorë për dorë* — *dorëpërdorë, sy ndër sy* — *syndërsy* etj., të cilat, megjithëse sipas «Drejtshkrimit të gjuhës shqipe» (1973) shkruhen, veças, ndjenja gjuhësore ka prirje t'i njohë si fjalë të përngjitura, sepse lidhjet sintaksore të gjalla në këtë tekstin e dhënë i kanë humbur.

Sipas kësaj ndjenje gjuhësore ato i ndeshim të shkruara edhe si fjalë e vetme, p.sh. «Vetëm kur u ndodh *ballëpërballë* me derën, ai e shpërfaqte që atje s'kish as drita e as njeri» (Nëntori, 1974); «M'u duk sikur e paqartë në atë çast ashtu si më tha ai: *krahëpër krah* me nusen e vet në mes të shtëpisë» (M. Zaloshnja, *Tregime të zgjedhura*, 1973); «... kemi Selim tënd, mjaft është ai një herë *dorëpërdorë*» (M. Zaloshnja, *Rreth zjarr*

9) Këto diskutime janë vlerësuar në studimin e A. Kostallarit «Kompozitat shqipe shirore dhe urdhërore të shqipes», SF, 1968, IV, f. 54-55. Aty theksohet me drejtë se formime të tilla (si *shkeleshko, foleqesh* etj. apo *shkel e shko, e qesh* etj. — J. Th.) «qëndrojnë në periferinë e kompozitave, e që, bile, të herë qëndrojnë midis juxtapozicionit e atyre frazeologjizmave gjuhësore që janë ekuivalente me një fjalë» (f. 54). Më tej theksohet gjithashtu me të drejtë se në të sqaruar këtë, vetëm kriteri semantik është i pamjaftueshëm, ai duhet plotësohet edhe nga kriteri morfologo-sintaksor e sidomos nga ai akcentim morfolgjik. Për këtë shih edhe J. Thomaj, *Mbi kufijtë e fjalës në gjuhën shqipe* (disa çështje të drejtshkrimit, SF, 1973, I, f. 137-154.

partizan, 1966); «U panë njëherë *syndërsy* dhe vunë re orën» (N. Sinaeri, Kokrra aguridhe, 1959) etj. Zbatimi i kriterëve semantik, morfologo-sintaksor dhe akcentologjik është po aq i vlefshëm edhe për këtë tip.

II. Një grup shumë të pasur e përbëjnë fjalët që bashkëlidhen me togfjalësha frazeologjike, të cilët nisin me parafjalën *me*. Janë disa mbiemra e ndajfolje dhe megjithëse në dukje kemi këtu fjalë të përbëra, rol të veçantë ka luajtur edhe përngjitja. Si frazeologjizmat ashtu dhe fjalët, që bashkëlidhen me ta, kanë kuptim të figurshëm e ngjyrim emocional. Edhe në këtë grup fjalësh nuk ka dallime kuptimore të dukshme në krahasim me frazeologjizmat përgjegjës.

Nga ana strukturore mund të mendohet se këto janë fjalë të formuara mbi bazën e frazeologjizmave kryesisht me strukturë *me + emër + mbiemër* (ose një fjalë tjetër me funksion cilësues — caktues), si: *me buzë të varura — buzëvarur, me buzë të lëshuara — buzëlëshuar, me buzë të plasur — buzëplatur, me turi varur — turivarur, me zemër të hapur — zemërhapur, me zemër të copëtuar — zemërcopëtuar, me zemër të çelur — zemërçelur, me zemër të plasur — zemërplatur, me zemër të thyer — zemërthyer, me gjak të ftohtë — gjakftohtë, me faqe të bardhë — faqebardhë, me duar bosh — duarbosh, me fytyrë të qeshur — fytyrëqeshur, me duar kryq — duarkryq, me fytyrë të vrenjtur — fytyrëvrenjtur, me gojë kyçur — gojëkyçur, me duar thatë — duarthatë, me kryet ulur — kryeulur, me kokë ulur — kokulur, me krahë hapur — krahëhapur, me ballin lart — ballëlart, me sy hapët — syhapët, me duar plot — duarplot, me kokë poshtë — kokëposhtë etj.*

III. Afër këtyre qëndron edhe një grup fjalësh të përbëra, që bashkëlidhen me frazeologjizma të tipit foljor, të cilët dalin në ligjërim në trajtë fjalie me vlera cilësore. Nga struktura këta frazeologjizma janë dy llojesh: a) *emër + emër*, p.sh. (që) e ka *zembrën gur — zemërgur*, (që) e ka *shpirtin kazmë — shpirtkazmë*, (që) e ka *kokën (si) shkëmb — kokëshkëmb*, (që) e ka *gojën (si) shpatë — gojëshpatë*, (që) e ka *kokën si të mushkës — kokëmushkë* etj.; (b) *emër + mbiemër*, p.sh. (që) e ka *mendjen të lehtë — mendjelehtë*, (që) e ka *kokën të fortë — kokëfortë*, (që) e ka *mendjen të trashë — mendjetrashë*, (që) e ka *gjuhën të gjatë — gjuhëgjatë*, (që) e ka *hijen të rëndë — hijerëndë* etj.

Po të krahasojmë këtë grup me grupin e mëparshëm (*me krahë hapur — krahëhapur* etj.), do të vërejmë se ato janë shumë të afërta ndërmjet tyre në bashkëlidhjet që kanë dhe në proceset formale e semantike që ndodhin gjatë krijimit të njësive njëfjalëshe, veçse strukturat e togfjalëshave frazeologjike përgjegjës dallohen. Kështu, në grupin e fundit nuk kemi strukturën *me + emër + emër* (ose *+ mbiemër*), d.m.th. nuk kemi *me zembrën gur, me kokën shkëmb, me mendjen të lehtë, me gjuhën të gjatë* etj.

Njësitë njëfjalëshe të këtij grupi kanë kuptim mbiemëror, ato bashkëjetojnë ende në gjuhë me frazeologjizmat përgjegjës, veçse ndryshe nga frazeologjizmat që japin cilësinë si një nocion të zberthyer, mbiemrat njëfjalësh e japin po atë cilësi si një nocion të vetëm të abstraktuar më tej dhe të lidhur gjithmonë me subjektin që e ka tiparin. Si të tillë këta mbiemra bëjnë pjesë në kompozitat pronësore të shqipes.

Tipari cilësor në këta mbiemra mund të shënohet në dy mënyra: a) në mënyrë të drejtpërdrejt, si: *mendjelehtë, zemërgjerë, dorështër-*

nguar, kokëfortë etj. Janë mbiemra që kanë dalë nga bashkimi i një emri me një mbiemër (krh. që e ka *kokën të fortë etj.*); b) në mënyrë të ndërmjetuar, nëpërmjet një krahasimi, i cili formon shkallën e parë të cilësimit, kurse tek mbiemrat ky cilësim përbën një shkallë të dytë më të përgjithësuar, sepse edhe mjetet formale të krahasimit nuk dallojnë më si: *kokëshkëmb* (krh. që e ka *kokën (të fortë si shkëmb)*, *zembrëgur* (krh. që e ka *zembrën (si) gur*) etj.¹⁰

Duhet thënë se nuk kemi gjithmonë togfjalësha frazeologjike përgjegjëse për gjithë fjalët e përbëra të këtij grupi. Kështu, kemi *mendje-madh*, porse togu «(që) e ka *mendjen të madhe*» nuk jeton në gjuhë.

IV. Një grup më vete e përbëjnë fjalët që bashkëlidhen me frazeologjizma të tipit foljor, por që kanë rend të përkundërt të gjymtyrëve, si *ngul këmbë — këmbëngulës (këmbëngulje)*, *marr pjesë — pjesëmarrës (pjesëmarrje)*, *i pi gjakun — gjakpirës, heq dorë — dorëheqje, i marr gjakun — gjakmarrje, lidh besën — besëlidhje, lëpin sahanë — sahanlëpirës, derdh gjakun — gjakderdhje, i laj duart — duarlarë etj.* Këtu frazeologjizmi është një model strukturor dhe kuptimor, me të mund të lidhim fjalën e përbërë që ka si gjymtyrët kryesore ashtu edhe kuptimin e frazeologjizmit përgjegjës. Por lidhjet ndërmjet tyre, pa dyshim, nuk janë në një vijë të drejtë. Ka shumë formime nën ndikimin e modeleve të huaja; ndërkaq duhet thënë se gjuha shqipe ka qenë një terren i përshtatshëm për prodhimtarinë e këtij tipi, siç vërehet edhe në formime të tjera të planit jofigurativ (p.sh. *bashkëngjit, bashkëjetoj, bashkëpunoj, bashkërendit, bashkëveproj etj.*). Dihet që këto janë kalkime, mirëpo shqipja vetë i ka togjet përgjegjëse *ngjit bashkë, jetoj bashkë, punoj bashkë, rendit bashkë, veproj bashkë etj.* Veç këtyre, një dallim të tillë nga rendi i gjymtyrëve e kemi edhe tek disa kompozita dëshirore e urdhërore që janë përmendur më parë, si *dorëtharë — t'u thaftë dora, vulëhumbur — të humbtë vula etj.* e kjo tregon se nuk kemi këtu një bashkëlidhje burimi të drejtpërdrejtë, d.m.th. *vulëhumbur* bashkëlidhet me togun *të humbtë vula*, porse është formuar mbi bazën e togut *vulë (e) humbur*.

Ç'vërejmë tek ky grup njësisht? Së pari, vërejmë se bashkëlidhja ndërmjet kompozitës dhe togfjalëshit frazeologjik është shumë e dobët, madje më e dobëta në krahasim me grupet e tjera (krahaso: *vë re — vërej; me krahë hapur — krahëhapur; (që) e ka gjuhën të gjatë — gjuhëgjatë*). Këtu nuk mund të thuhet se kompozita ka dalë «nga përngjitja e togfjalëshit frazeologjik», as se është formuar «mbi bazën e frazeologjizmit». Ne mund të vendosim vetëm një bashkëlidhje të dobët semantiko-strukturorë ndërmjet tyre. Në shkallëzimin e bashkëlidhjeve të kompozitave me frazeologjizmat, kjo përbën shkallën më të ulët. Së dyti, në këtë grup njësisht nuk kemi bashkëlidhje njësisht gramatikusht homogjene, meqenëse trajta foljore e kompozitës si hallkë ndërmjetëse në gjuhë nuk jeton, d.m.th. folje të tilla si *këmbëngul, pjesëmarr, gjakpi, dorëheq, gjakmarr, besëlidh, sahanlëpij, gjakderdh, duarlaraj etj.*, të cilat mund t'i lidhim drejtpërdrejt me togfjalëshat frazeologjike përkatës, nuk

10) Për lidhjet disashkallëshe në kompozitat ekzocentrike të shqipes përgjithësisht, në emra e në mbiemra, shih. A. Kostallari, «Kompozitat ekzocentrike të shqipes si tema fjalëformuese», BUSHT, Seria shkencat shoqërore, 1962, III. Po këtu edhe për aktivizimin e këtyre kompozitave si tema fjalëformuese.

janë formuar në gjuhën shqipe¹¹. Edhe këtu kalkimet kanë luajtur dhe luajnë rol, jo vetëm si kalkime të mirëfillta, po edhe si kalkime në bazë modelesh. Së treti, në lidhje me vlerën leksiko-gramatikore të njësive (pra, me kuptimin kategorial), si dhe me dobësinë e bashkëlidhjes së kompozitës me togfjalëshin frazeologjik, kemi këtu dallime kuptimore më të theksuara se në grupet e tjera. Për këtë mjafton të krahasohet nga ana kuptimore i *laj duart* me *duarlarë* dhe ndonjë tjetër.

Nga ana strukturore kompozitat e këtij grupi përbëhen nga tema e një emri + tema e një emri foljor prapashtesor, prandaj në vijë të drejtpërdrejtë mund të mendohej se edhe bashkëlidhen me tipin emëror të frazeologjizmave, si p.sh. *këmbëngulje* me *ngulja këmbë* etj., por meqenëse ky tip emëror i frazeologjizmave nuk është i natyrës së gjuhës së folur të zakonshme dhe në përgjithësi është i ri, mendojmë se ai nuk mund të shërbejë si hallkë ndërmjetëse (midis frazeologjizmit foljor dhe fjalës së përbërë) për të vendosur bashkëlidhjen ndërmjet tyre. Bashkëlidhja vendoset ndërmjet *ngul këmbë* dhe *këmbëngulje*, *marr pjesë* dhe *pjesëmarrës* etj.

Dallimi në rendin e gjymtyrëve do shpjeguar edhe me ndikimin e modeleve të huaja, por edhe me arsye të brendshme të shqipes, që duhen zbuluar e studjuar.

* *
*

Si e përmendëm edhe më parë, ana kuptimore është një nga elementet thelbësore të bashkëlidhjes ndërmjet kompozitave dhe frazeologjizmave përgjegjës. Tek format e tyre ne shohim më qartë se ç'kanë të përbashkët dhe ç'kanë të ndryshme, kurse tek kuptimi, veç kësaj, shohim edhe dukuri të zhvillimit, d.m.th. veç asaj që është ruajtur a është trashëguar nga njëra njësi tek tjetra, shohim edhe atë të ndryshme që përbën zhvillim dhe që dobëson forcën e bashkëlidhjes së këtyre njësive.

Mund të themi se në shumicën e rasteve kuptimi leksikor kategorial dhe ai i veçantë janë të njëjtë si tek kompozitat ashtu edhe tek frazeologjizmat përgjegjës, pavarësisht në se kompozita është formuar drejtpërdrejt nga përngjitja e gjymtyrëve të frazeologjizmit, mbi bazën e këtij frazeologjizmi ose në një bashkëlidhje më të largët me të. Po ashtu janë të njëjtë karakteri figurativ i kuptimit dhe ngjyrimi emocional-shprehës (si e pamë tek ballafaqimet *vë re* — *vërej*, *shkel e shko* — *shkeleshko*, *me krahë hapur* — *krahëhapur*, (që) e ka *zembrën gur* — *zemërgur* etj.).

Në raste të tjera ndryshon kuptimi i përgjithshëm kategorial, sepse ndryshon kategoria leksiko-gramatikore, p.sh. *ec e jakë* — *ecejaket*, *thash e them* — *thashethemet*, *marr pjesë* — *pjesëmarrës* etj. Me këtë ndryshim vjen edhe zhvillimi semantik individual i njësisë njëfjalëshe, në

11) Le të krahasohen këto me *heq udhën* — *udhëheq* — *udhëheqje* / / *udhëheqës*, ku vargu i hallkave formuese është i plotë. Për të plotësuar këtë varg me hallkat formuese që mungojnë vërehen në shqipen e sotme riformime regressive, si:

Ngul këmbë — . . . : : : : : — *këmbëngulje*
ngul këmbë — *këmbëngul* — *këmbëngulje*

të cilën, mbi bazën e një semanteme foljore ngrihet kuptimi emëror, mbiemëror a ndajfoljor.

Në disa formime njëfjalëshe ka ndryshime semantike më të thella, jo vetëm kategoriale, por edhe individuale. Kuptimi leksikor i mirëfilltë i frazeologjizmit, që ka shërbyer si temë semantike, nuk ruhet plotësisht, në fjalën e formuar kemi një kuptim a nuancë tjetër kuptimore, p.sh. *marrëveshje* «pajtim dhe rënie në ujdi me një tjetër për rregullimin e çështjeve me interes të përbashkët», nga ndërtimi i përgjigjet frazeologjizmit *marr vesh* (sikurse gjithë grupi përkatës), kurse nga kuptimi nuk lidhet me të (*marr vesh* 1) dëgjoj; 2) kuptoj; 3) mësoj; 4) bindem, po me strukturën kuptimore të shprehjes «*mirrem vesh me...*». Të tilla ndryshime vërehen edhe në raste të tjera. Ky fakt duhet pasur parasysh kurdoherë, që sidomos në planin semantik të mos mendohet një kalim mekanik e në vijë të drejtë nga frazeologjizmi në fjalë.

Disa kompozita të tipeve që po trajtojmë janë bisemantike, kanë kuptim të drejtpërdrejtë, fizik dhe kuptim të figurshëm, idiomatik, p.sh. *kokulur* 1) me kokë ulur, varur; 2) i bindur, i shtruar etj. Edhe kjo strukturë kuptimore e gjen përgjegjësen e vet tek struktura kuptimore e togfjalëshave të lirë e frazeologjike. Siç dihet, njësitë frazeologjike në gjuhën shqipe kanë paralele togfjalëshat e lirë me ndërtim të njëjtë, por me kuptim të drejtpërdrejtë, p.sh. *me gojë hapur I* si togfjalësh i lirë me kuptim të drejtpërdrejtë, fizik dhe *me gojë hapur II* si njësi frazeologjike me kuptim të figurshëm, idiomatik.

Togfjalëshin e lirë dhe atë frazeologjik i ndajmë si dy njësi më vete «homonime», për shkak të ndryshimeve të thella nga vlera dhe funksioni i tyre në gjuhë. Por të dy kuptimet leksikore të këtyre dy togfjalëshave përmbahen tek kompozita përgjegjëse, e cila del kështu si njësi bisemantike, me lidhje formale e kuptimore të dyanshme. Këtë lloj bashkëlidhjeje mund ta japim kështu;

I. me kokë ulur	<i>kokulur</i>	1) me kokë ulur, varur;
II. me kokë ulur		2) i bindur, i urtë etj.
I. me gojë hapur	<i>gojëhapur</i>	1) me gojë të hapur;
II. me gojë hapur		2) i habitur, i shastisur.
I. me gojë mbyllur	<i>gojëmbyllur</i>	1) me gojë mbyllur;
II. me gojë mbyllur		2) i heshtur, pa fjalë etj.
I. me krahë hapur	<i>krahëhapur</i>	1) me krahë hapur;
II. me krahë hapur		2) me gëzim, me bujari.
I. me sy hapur	<i>syhapur</i>	1) me sy hapur;
II. me sy hapur		2) vigjilent; i kujdesshëm.
I. me duar lidhur	<i>duarlidhur</i>	1) me duar të lidhura;
II. me duar lidhur		2) pa punë, inaktiv.
I. që e ka gjuhën të gjatë	<i>gjuhëgjatë</i>	1) që e ka gjuhën të gjatë;
II. që e ka gjuhën të gjatë		2) llafazan, fjalëshumë etj.

Është për t'u shënuar se në njësitë njëfjalëshe zotërojnë kuptimet e dyta, d.m.th. kuptimet figurative dhe në ligjërim i ndeshim zakonisht me këto kuptime (*gjuhëgjatë* «llafazan», *syhapur* «vigjilent», *kokulur* «i bindur, i shtruar», *gojëmbyllur* «i heshtur» etj.). Për disa prej tyre ka edhe formime paralele, tek të cilat pesha figurative e kuptimit është më e madhe (si: *krahëhapët*, *syhapët* etj.).

Disa shembuj: «Babai kaloi përpara tyre *kokulur*, i vrarë, i dërmuar». (Dh. Shuteriqi, Këngë në minierë, 1968) — «As kemi qenë as do të jemi më *kokulura* e të ndrojtura, por bija të Partisë së lavdishme» (Zëri i popullit, 1967); «Ata u sulën *krahëhapur* dhe u përçafuan» (Ylli, 1965) — «E prisja *krahëhapur* çdo herë që më vinte, se më digjte malli për të» (KLSH); «Kish fjetur me hope dhe të shumtën e kohës kish ndenjtur *syhapur*» (F. Gjata, Brezat, 1968) — «Njerëzit ishin më të gëzuar dhe mendonin ndryshe, flisnin *syhapur* si zot shtëpie» (S. Spasse, Buzë liqenit, 1965); «Dallgët më nxorën në breg, ku mbeta *gojëhapur*» (Ylli, 1961) — «Turma mbeti *gojëhapur*» (F. Gjata, Brezat, 1968) etj. Po ashtu: «Dhe ky mendim... shpesh e kishte bërë ta priste *syhapët* dritën në shtrat» (L. Qafëzezi, Dielli u duk përsëri, 1972) — «... të jeni edhe në të ardhshmen *syhapët* e luftëtarë për të ruajtur atdheun dhe pushtetin popullor» (Enver Hoxha, Vepra, X, 1972); «Gjyshi *gojëhapët* rrinte e plaka gati ish kotë / Bri votrës» (Ll. Siliqi, Mësuesi, 1955) «Vajza dëgjonte *gojëhapët*. Herëpashere ajo vetë përpiquej të përsëriste fjalët» (F. Arapi, Dhjetor i shqetësuar, 1970) etj.

Me kompozitat mbiemërore e pjesërisht me ato ndajfoljoret vargu përbëhet nga tri shkallë, ai bashkon a lidh tri njësi; në këtë mënyrë në shqipe krijohet një varg i lidhur formimesh frazeologjike e njëfjalëshe: var buzët — me buzë varur — buzëvarur; kyç gojën — me gojë kyçur — gojëkyçur; prish gjakun — me gjak të prishur — gjakprishur; i hap zemrën — me zemër të hapur — zemërhapur; më ngrin gjaku — me gjak të ngrirë — gjakngrirë; var kokën — me kokë varur — kokëvarur etj.

Ndërrimi i kuptimit kategorial në këto raste kryhet që në vargun frazeologjik (var buzët — me buzë varur), kurse fjala e përbërë lidhet me kuptimin kategorial të halkës ndërmjetëse, d.m.th. të tipit mbiemëror të frazeologjizmit. Ndërkaq përbërësja (komponentja) kryesore e kuptimit leksikor mbetet e përbashkët për të gjithë vargun; p.sh. tek var buzët — me buzë varur — buzëvarur është po ajo komponente semantike fillestare, d.m.th. sikurse del tek vargu i fjalëve zemërohem — i zemëruar (me zemërim) — i zemëruar.

Këtu kemi lidhje semantike dyshkallëshe, ndryshe nga rastet kur mungon tipi frazeologjik foljor (me duar bosh — duarbosh etj.), ku kemi lidhje semantike njëshkallëshe.

Në disa raste të rralla lidhja këputet disi (në planin kuptimor) që në fazën e njërive frazeologjike, sepse në këto njësi (në tipin foljor dhe në atë mbiemëror) ka ndryshime më të thella kuptimore, si p.sh. *mbyll sytë* «1) nuk vë re; 2) vdes» — me *sy mbyllur* «lehtësisht; kuturu» — *symbyllur* «lehtësisht; kuturu»; *hap gojën* «flas; kërkoj diçka» me *gojë hapur* «i çuditur; i mahnitur» — *gojëhapur* «i çuditur, i mahnitur; hap sytë» «kam kujdes» — me *sy hapur* «i hutuar; pa kuptuar gjësendi» — *syhapur* «i hutuar; pa kuptuar gjësendi etj. Në këto raste fjala e përbërë lidhet më ngushtë kuptimisht me tipin mbiemëror të frazeologjizmit dhe largohet shumë nga tipi foljor.

Gramatikalizimi dhe leksikalizimi tek njësitë që bashkëlidhen me togfjalësha frazeologjike ka po ato veçori si dhe tek kompozitat në përgjithësi: tek emrat, mbiemrat e foljet treguesit gramatikorë janë shenjë e qartë e mbylljes së strukturës dhe e njëfjalësisimit të njësisë; tek pjesët e pandryshueshme të ligjëratës duhen vështruar njësimi kuptimor, li-

dhjet sistemore, funksionet e lidhjet brenda sintagmës, desemantizimi i gjymtyrëve, faktori akcentologjik e të tjera. Kështu kemi nga një *anë*; *ecejakET*, *thashethemET*, *farefisI*, *vëreJ*, *zëvendëSI*; *mëndjemadhI*, *mëndjehëET* etj.; nga ana tjetër; *krahëhapur*, *shkeleshko*, *ballëlart*, *duar plotë* etj.¹² Për të ndriçuar më qartë kuptimin e fjalëve të përbëra të tipit mbiemëror e ndajfoljor, rëndësi të veçantë marrin edhe lidhjet sintagmatike. Si rregull të përgjithshme në gjuhën e sotme shqipe mund të formulojmë këtë: kur njësia lidhet e plotëson një folje, një emër foljor ose një mbiemër prejppjesor, atëhere ajo ka vlerë ndajfoljore (si: punon *shkeleshko* *punë e bërë shkeleshko*, të punuarit *shkeleshko*), ndërsa kur lidhet e plotëson foljën këpujore *jam* ose një emër jofoljor, atëhere ka vlerë mbiemërore (si: puna *shkeleshko*, ai është *foleqesh*).

* *
*

Fjalët e përbëra e të përngjitura, që bashkëlidhen me togfjalësha frazeologjike, meqenëse në përgjithësi kanë ngjyrim emocional të theksuar kanë edhe vlera stilistike të mëdha, si vetë frazeologjizmat përgjegjëse. Fusha e krijimit dhe e përpunimit të këtyre mjeteve në përgjithësi në gjendjen e sotme të gjuhës shqipe nuk ka ndonjë rëndësi të veçantë meqenëse fusha e përdorimit të tyre po bëhet pothuajse e pakufishme. Ndër variantet e gjuhës letrare, e folura shquhet për një pasuri më të madhe me këto mjete, por prej kësaj një shumicë ka kaluar ose po kalon dita-ditës edhe në të shkruarën. Ndërkohë po bëhet edhe një përskaftje stilistik e këtyre mjeteve; fjalë me përmbajtje «të rëndë» (si: *truderi*, *kokëkungull*, *kokëmish*, *turispec* etj.) mbeten gjithnjë mjete të ligjëritimit të thjeshtë dhe vetë përmbajtja leksikore, që kushtëzon tërësisht ngjyrimin emocional negativ, nuk i lejon të kalojnë kufijtë e këtij ligjëritimi. Përkundrajt këtyre, njësitë me përmbajtje asnjansë ose me ngjyrim emocional pozitiv (si *vërej*, *farefis*, *zemërmirë*, *gjakftohë* etj.) i kanë kapërcyer këta kufij dhe nëpërmjet ligjëritimit bisedor kalojnë edhe në ligjëritimin libror, si dhe në stile të ndryshme funksionale. Më i pasur ndër këto të fundit është stili i letërsisë artistike e këtu dallohet proza. Po vërejtje shtrimi stilistik i fjalëve të tilla, së bashku me frazeologjizmat përgjegjës përbën një problem që do studjuar veçanësisht. Analiza kuptimore dhe stilistike, sidomos duke ballafaquar kategorinë frazeologjike me atë njëfjalëshe, i sjell një shërbim të drejtpërdrejtë trajtimit leksikografik të këtyre mjeteve dhe punës mësimore me gjuhën amtare në shkollë.

R é s u m é

GROUPES DE MOTS CORRELATIFS A DES EXPRESSIONS PHRASEOLOGIQUES

La corrélation des composés avec les groupes de mots est connue depuis les premiers pas que fit la linguistique comparative. On peut désormais inclure dans une étude particulière aussi ces mots composés ou agglutinés qui s'associent à des groupes de mots phraséologiques. De quelle nature est cette corrélation? Elle est de nature et de niveaux différents. La corrélation, d'un composé avec un groupe

12) Shih më gjerë tek «Mbi kufijtë e fjalës në gjuhën shqipe...» (sipas shënimit 9).

de mots phraséologiques se trouve tant dans sa forme (sa structure), que dans son contenu (son sens). Un groupe de mots dérive directement de la phraséologie, avec agglutination de ses parties, d'autres mots ont une corrélation extrêmement faible avec la phraséologie et on ne peut pas dire qu'il dérivent directement d'elle. Ce niveau de corrélation, ainsi que les processus sémantiques qui interviennent durant la formation des composés de ces types, sont mis au jour lorsqu'on étudie les groupes mêmes de composés qui sont en corrélation avec la phraséologie.

On avait noté, antérieurement aussi, quelques corrélations des composés avec la phraséologie, dans des études ou des grammaires. L'auteur s'arrête surtout à celles d'A. Xhuvani, K. Cipo, E. Çabej, M. Domi, Sh. Demiraj, et notamment à celle d'A. Kostallari. Tout de même, cette question n'a pas été débattue dûment, au point de vue théorique, on n'a pas même effectué le groupement des mots en corrélation avec la phraséologie. Les auteurs qu'on vient de mentionner ont apporté quelques mots composés et agglutinés, ils les ont confrontés avec les groupes de mots phraséologiques (p. ex. *pikërrënë* «atij që i ka rrënë pika» = qui a eu un coup d'apoplexie, etc.). Ils ont remarqué, durant leur comparaison, que le composé et la phraséologie sont en corrélation, que dans quelques cas le mot dérive de l'agglutination de la phraséologie, que les deux ont en commun la base de la formation, le coloris affectif, etc. Kostallari est parvenu à isoler, au moyen de cette confrontation, le groupe le plus grand des composés désidératifs affectifs.

Après ce bref aperçu historique de la question, l'auteur de cet exposé, J. Thomaj, analyse, quatre groupes de mots qui sont en corrélation avec la phraséologie:

I. Mots formés surtout à agglutination des parties des groupes de mots phraséologiques (rarement aussi à l'aide de préfixation).

Tels sont quelques verbes (comme *vë re* — *vërej* «faire attention; observer», *baj za* — *bëzaj* «appeler, héler; nommer quelqu'un», etc.);

quelques noms (comme *thash e them* — *thashetheme* «jaseries», *ec e jakë* — *ecëjake* «va-et-vient» etc.);

quelques adverbes (comme *anë e mbanë* — *anëmbanë* «de tout côté»; dans le monde entier», etc.).

Ce groupe est en cours de croissance par de nouvelles agglutinations:

II. Mots qui entrent en corrélation avec des groupes de mots phraséologiques commençant par la préposition *me*, tels des adjectifs et des adverbes (comme *me zemër të hapur* — *zemërhapur* «à coeur ouvert; franchement», *me faqe të bardhë* — *faqebardhë* «honorablement; honnêtement», *me duar kryq* — *duarkryq* «les mains croisées», *me krahë hapur* — *krahëhapur* «les bras ouverts», etc. Le mot et la phraséologie ont en commun les parties, les sens et le coloris affectif.

III. Mots qui entrent en corrélation avec des groupes de mots phraséologiques, qui ont dans le discours la forme d'une proposition, tels des adjectifs (comme *e ka zemrën gur* — *zemërgur* «au coeur de pierre», *e ka mendjen të lehtë* — *mendjelehtë* «étourdi, irréfléchi, distrait», etc.). A la différence du groupe précédent, on n'a pas ici des expressions phraséologiques correspondantes ayant la structure de ce groupe (c'est-à-dire qu'il n'y a pas *me zemër gur* litt. «avec le coeur de pierre», etc.).

IV. Mots qui entrent en corrélation avec des groupes de mots phraséologiques de type verbal, mais qui tiennent un ordre contraire des parties, tels des noms et des adjectifs (comme: *ngul këmbë* — *këmbëngulje* «insistance», *i pi gjakun* — *gjakëpirës* «sucer le sang à quelqu'un: assassin», *i laj duart* — *duarlarë* «se laver les mains, être quitte», etc. Ce groupe concorde, comme structure, avec les formations populaires désidératives, comme *të humbët vula* — *vulëhumbur* «perdre le crédit, discrédité», *t'u thaftë dora* — *dorëtharë* «litt. que ta main se sèche; rien-tenant»,

etc. La corrélation du composé avec la phraséologie est plus faible, n'ayant pas, ex., un thème productif: *këmbëngul*, *gjakpi*, etc. pour la formation de noms *mbëngul*, *gjakpirës*, etc.

L'aspect sémantique constitue l'élément le plus important dans la corrélation des mots avec les groupes de mots phraséologiques. Généralement, en tant que composition, aussi bien le composé que la phraséologie correspondante ont le même contenu et coloris affectif, cependant, il y a des cas où ceux-ci ne correspondent pas. Change dans quelques cas, le sens catégoriel: (comme *ec e jakë* et *ecejaket* «va-et-viens la navette qu'on fait pour un travail», etc.). Dans d'autres cas, change aussi le sens particulier (comme *marr vesh* — *marrëveshje* «je comprends; entente, accord» — *laj duart* «je me lave les mains; en être quitte», etc.).

D'autres composés reçoivent en patrimoine tant le sens du groupe de mots libres au même titre que celui du groupe de mots phraséologique (ex. *kokulur*, «la basse», *gojëhapur* «bouche-bée», *duarlidhur* «mains liées, immobilisé», etc.).

Sont formées ainsi, en albanais, aussi des suites d'unités qui entrent en corrélation, comme: *hap gojën* «ouvrir la bouche» (groupe de mots libre) — *hap gojë* «bâiller» (groupe de mots phraséologique verbal) — *me gojë hapur* «(rester) bouche-bée» (groupe de mots phraséologique adverbial) — *gojëhapur* «bouche-bée» (composé), etc.

L'auteur Thomaj étudie aussi plus loin les rapports entre les chaînons de cette suite.